



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2019

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8402,
DATË 10.9.1998, “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN
E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Kudo në ligj bëhen këto zëvendësime të termave:

- a) “Investitor” me “Zhvillues”;
- b) “Leje shfrytëzimi” me “Certifikatë përdorimi”;
- c) “Procesverbal kolaudimi” me “Akt kolaudimi”;
- ç) “Autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit” me “Autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit”;
- d) “Autoriteti përkatës i planifikimit” me “Autoriteti përgjegjës i planifikimit të territorit”;
- dh) “Zyra e urbanistikës e njësisë vendore përkatëse” dhe “Autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të njësisë vendore” me “Autoriteti vendor i zhvillimit të territorit”;
- e) “Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” me “Agjencia Shtetërore e Kadastrës”.

Neni 2

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1, si më poshtë vijon:

“Neni 4/1

Të gjitha objektet, të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar, i nënshtrohen procesit të auditimit teknik. Rregullat për mënyrën se si do të zbatohet auditimi dhe cilat do të jenë subjektet që do ta kryejnë atë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Neni 6 riformulohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha:

- a) ndërtimet publike;
- b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë;
- c) objektet me akses publik.

Me “objekte me akses publik”, sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku, pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadione, markete, etj.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI